



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria -Vlada-Government

Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (SHSKUK)

Univerzitetska Bolnička i Klinička Služba Kosova (UBKSK)

Hospital and University Clinical Service of Kosovo (HUCSK)



SHËRBIMET SPITALOR KLINIK DHE UNIVERSITAR I KOSOVËS

PERIUDHA 2014-2017

Ky dokument tregon punën e kryer nga menaxhmenti i Shërbimit Spitalor Klinik dhe Universitar të Kosovës (SHSKUK). Sfidat dhe Sukseset gjatë kesaj periudhe kohore me reformën në sistemin shëndetësor.

Përgaditur nga:

Curr Gjocaj-Drejtor i Përgjithshëm

Liridon Gashi-Zyra e Drejtorit SHSKUK

PËRMBAJTJA E TABELËS

Përmbajtja

Hyrje _____	2
Sfidat me burimet njerzore _____	3
Sfidat në SHSKUK _____	6
Sfidat tjera në Sistemin Shëndetësor SHSKUK _____	17
Të arriturat në SHSKUK _____	20
SWOT ANALIZA.....	27
Rekomandimet.....	29
Konkluzioni.....	31
Informatat kontaktuese _____	32


LISTA E SHKURTESAVE

SHSKUK	Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës
MSH	Ministria e Shëndetësisë
BD	Bordi Drejtues
MF	Ministria e Financave
AFSH	Agjensioni I Financimit Shëndetësor
QKUK	Qendra Klinike Universitare e Kosovës
QKUSK	Qendra Klinike Universitare Stomatologjike e Kosovës
QKMP	Qendra Kombëtare e Mjekësisë Sportive
QKMS	Qendra Kombëtare e Mjekësisë Sportive
QKTGJ	Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut
QKT	Qendra Kombëtare e Telemjekësisë
SP	Spitali i Përgjithshëm
QSHMK	Qendrat e Shëndetit Mendor me Shtëpitë për Integrim në Bashkësi
QIRSK	Qendra për Integrimin dhe Rehabilitimin e të Sëmurëve Kronik Psikiatrik
BQ	Barnatorja Qëndrore

Hyrje

Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës (SHSKUK) është institucion unik, i formuar sipas Ligjit për Shëndetësi nga Qeveria e Republikës së Kosovës, përdërisa Statuti i Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës është miratuar në mbledhjen e 148 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me vendim nr. 05/148, datë 11.09.2013. Formimi i SHSKUK është e saktësuar në nenin 62 të Ligjit për Shëndetësi. Në paragrafin e parë të këtij neni, theksohet se Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës themelohet si institucion autonom dhe i pavarur publik shëndetësor, me rëndësi të veçantë publike, me seli në Prishtinë. SHSKUK përbëhet nga institucionet e nivelit dytësor dhe tretësor të kujdesit shëndetësor në sektorin publik të shëndetësisë. Institucionet shëndetësore të nivelit dytësor dhe tretësor të kujdesit shëndetësor, të cilat përbëjnë SHSKUK-në, janë si vijon:


- 1.1. Qendra Klinike Universitare e Kosovës (QKUK);
- 1.2. Qendra Klinike Universitare Stomatologjike e Kosovës;
- 1.3. Qendra Kombëtare e Mjekësisë së Punës në Gjakovë;
- 1.4. Qendra Kombëtare e Mjekësisë Sportive
- 1.5. Qendra Kombëtare e Telemjekësisë;
- 1.6. Spitali i Përgjithshëm në Mitrovicë;
- 1.7. Spitali i Përgjithshëm në Gjilan;
- 1.8. Spitali i Përgjithshëm në Pejë;
- 1.9. Spitali i Përgjithshëm në Gjakovë;
- 1.10. Spitali i Përgjithshëm në Prizren;
- 1.11. Spitali i Përgjithshëm në Ferizaj;
- 1.12. Spitali i Përgjithshëm në Vushtrri;
- 1.13. Qendrat e Shëndetit Mendor me Shtëpitë për Integrim në Bashkësi;(Prishtinë, Mitrovicë, Gjilan, Prizren, Pejë, Gjakovë dhe Gjilan;
- 1.14. Qendra për Integrimin dhe Rehabilitimin e të Sëmurëve Kronik Psikiatrik në Shtime.
- 1.15. Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut¹



¹ Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut edhe pse është në statut të SHSKUK-së, nga fillimi i reformës shëndetësore nuk ka raportuar në SHSKUK, por direkt i është përgjigjur MSH-së. Gjë që ka shkaktuar kaos në organizim të punës. Brenda çdo Spitali kemi hapsira të ndara për këto njësi po nuk kemi autoritet për veprim, dhe për të gjitha shpenzimet (rrymë, ujë, etj) paguhen nga SHSKUK.

SFIDAT ME BURIME NJERZORE

Gjithsej të punësuar në SHSKUK janë 6733 punonjës, 4350 i përkasin gjinisë femërore dhe 2383 janë meshkuj.



Struktura gjinore në SHSKUK		
	Meshkuj	Totali
Femra		
4350	2383	6733

Figura, tregon qe 35% janë meshkuj të punësuar dhe 65% e te punësuarve janë femra.

Njesia perberese e SHSKUK	Mjekë specialiste	Infermiere	Kuader tjetër jomedicinal	Totali
Sherbimet Rajonale Dytesore SPITALET	685	2.064	438	3.187
Sherbimi Terciar Shendetesore QKUK	618	1895	507	3020
Sherbimi Shendetit Mendor	26	186	36	248
QSKUK-Sherbimet Terciare Shendetesore	56	78	20	154
Programet Tjera Terciare	28	48	48	124
GJITHSEJ	1.413	4.271	1.049	6.733

Tabela, tregon që gjithsej mjekë specialist janë 1413, infermier janë 4271 dhe kuader tjetër jomedicinal është 1049.

Kërkesat për personel janë mjaftë të mëdha nga njësitë përbërse të SHSKUK-së, gjë e cila paraqet një sfidë të veçantë, e cila na pa mundëson të arrijmë Misionin tonë për ofrim të

SHËRBIMI SPITALOR KLINIK DHE UNIVERSITAR I KOSOVËS

shërbimeve shëndetësore. Kërkesat konkrete janë adresuar në insitucionet përkatëse në pothuajse në cdo periudhë kohore.

Kërkesat për personel shëndetësor i kemi nda në ato urgjente, sipas nevojave dhe sipas standareve, tableat në vijim do të shfaqin kërkesat reale dhe realizimi i tyre kërkesave:

Kerkesat per Mjek Specialist ne SHSKUK			
Njesia	Kerkesat Urgjente	Realizuar	Diferenca
QKUK	95	92	-3
Spitalet e Pergjithsh	99	77	-22
Programet tjera	28	26	-2
Gjithsej	222	195	-27


Kerkesat për Infermier në SHSKUK			
Njesia	Kerkesat Urgjente	Realizuar	Diferenca
QKUK	250	0	-250
Spitalet e Pergjithsh	92	0	-92
Programet tjera	19	0	-19
Gjithsej	361	0	-361

Nga Ministria e Shëndetësisë janë marrë parasysh vetëm kërkesat urgjente dhe janë plotësuar vetëm kërkesat për Mjek specialist, nga gjithsej 222 kërkesa janë realizuar 195 pozita.

Kerkesat per staf jo medicinal			
Njesia	Kerkesat Urgjente	Realizuar	Diferenca
QKUK	50	0	-50
Spitalet	47	0	-47
Programet tjera	20	0	-20
Gjithsej	117	0	-117

Kërkesat Urgjente për staf infermior në SHSKUK ishin gjithsej 361 pozita për infermier si kërkesa urgjente poër as një kërkesë shtesë në këtë kategori të punëtorëve nuk është plotësuar. Gjithashtu, kërkesat për staf jo medicinal janë prej 117 punëtor të ndryshëm por edhe këtë kategori nuk e kemi pasur as një mbështetje për rritje të numrit të punëtorëve.

Permbledhje e kerkesave shtese (urgjente) në SHSKUK	
Mjek	27
Infermier	361
Jo medicinal	117
Gjithsej	505
Buxheti shtese per plotesim të nevojave urgjente	3.696.600,00
Buxheti shtese për lehonat	258.650,00
Buxheti shtese per punëtor te pensionuar	288.650,00
Buxheti shtese për rrezikshmëri	6.889.561,00
Buxheti për kardiokirurgji (stimulim)	225.000,00
Gjithsej	11.358.461,00




Gjithsej kërkesat shtesë (urgjente) janë edhe për 505 punëtor, infermier kërkohen 361 punëtor shtesë apo 72%, 27 mjek specialist apo 5% të gjithsej kërkesave urgjente. Punëtor jo medicinal

kërkohen 117 apo 23%. Të shprehur në vlerë monetare 3.6 milion euro shtesë për 505 punëtor. Tabela e më sipërme tregon edhe shtesat obligative tjera të cilat kërkohen për një vitë kalendarikë gjithsej 7.6 milion euro. Në total kategoria e pagave kërkon edhe 11.3 milion euro.

Sfidat në SHSKUK 2014-2017

- **Financimi Shëndetësor**

Financimi shëndetësor kryesisht realizohet nga buxheti i shtetit (thesari) dhe një përqindje e vogël është nga të hyrat vetanake. Me reformën në shëndetësi, ShSKUK, nga 1 Janari i vitit 2015, ka filluar të operojë si njësi e pavarur buxhetore me të gjitha kategoritë ekonomike nga Ministria e Shëndetësisë. Në vitin 2016, me amendamentimet e propozuara nga Komisioni për buxhet dhe Financa i Republikës së Kosovës, dhe me votimin e ligjit të buxhetit nga deputetet e Republikës së Kosovës, është bërë bartja e kategorive ekonomike (Kapitale dhe barëra dhe material shpenzues) në AFSH/MSH. Figura e më poshtme tregon ndarjet buxhetore sipas viteve në Sistemin Shëndetësor, konkretisht në nivelin dytësor dhe tretësor.



Në vitin 2014, buxheti total ishte 84,6 milion euro, në vitin 2015 ka pasur rritje deri në 86,3 milion euro, dhe gjatë vitit 2016 kishim një rënie të buxhetit në 70.2 milion euro. Ndërsa është planifikuar që buxheti i vitit 2017, të rritet në 70.7 milion euro (Buxheti i vitit 2016 dhe 2017 përveç zvogelimit të tijë është hequr edhe kategoria e barërave dhe një pjesë kapitale e cila është bartur në MSH/AFSH).

Përveq buxhetit të pa mjaftueshëm në të gjitha kategoritë buxhetore, ndër vite kemi pasur edhe shkurtime buxhetore me rishikimet buxhetore të cilat kanë ndodhur.

SHËRBIMI SPITALOR KLINIK DHE UNIVERSITAR I KOSOVËS

	buxheti 2014	buxheti 2015	buxheti 2016	buxheti 2017
Buxheti i Aprovuar	84.608.764,00	86.374.265,00	70.240.653,00	70.714.567,00
Buxhetir i rishikuar	81.082.361,00	87.501.839,00	69.863.040,00	69.763.167,00
Diferenca	- 3.526.403,00	1.127.574,00	- 377.613,00	- 951.400,00

1. Buxheti i SHSKUK qe nga themelimi i saj ka qenë buxhet i cili ne vend te shenoj rritje ai ka shenuar zvoglim ne vijat buxhetore: Mallera e sherbime; barera dhe material hargjues nga LE dhe projekte kapitale, ndersa rritje ka shenuar vetem ne vijen buxhetore paga dhje meditje ku kjo rritje ka qene si pasoje e zbatimit te pageses se 0.5% per cdo vite te pervojës se punes
2. Si vite i cili ka qene me i organizuar dhe me efektiv ka qene viti 2015 kur Menagjimin e bxuhetit te barerave dhe projekteve kapitale e kane kryer Programet Buxhetore te SHSKUK. Ne kete vite ka qene nje furnizim shume me i mire dhe me i organizuar me barera dhe material hargjues nga Le dhe furnizim me paisje mjekesore.
3. Ne vitet 2016 dhe 2017 SHSKUK ka pasur nje furnizim jostabil me barera dhe material hargjues nga Le ne nje ane dhe nuk ka pasur fare funizim me paisje mjekesore pasi qe Buxheti per kete destinim i cili eshte barte ne MSH ka shkuar ne suficit. Gjate ketyre dy viteve QKUK nuk ka blere kurfare apsijesh nga Buxheti i Konsolidura i Republikës se Kosoves
4. Numri i te punesuarve ne keto tri vite nuk ka pesuar kurfare ndryshimi edhe pse ne kete periudhe jane leshuar ne perdorim shume objekte dhe sherbime te reja /Spitali i Vushtrise; Spitali Mitrovices; Kardiokirurgjia me Kardiologjin Invasive etj) e kjo ka bere qe shumica e Njesive te jene me mungesa te medha ne veqanti te kuadrit infermierise qe pamundeson organizimin e punes normale per ofrim te sherbimeve shendetesore 24 ore
5. Perveq mosfurnizimit me paisje te re ne dy vitet e fundit kemi pasur edhe veshtersi me buxhetin e zvogluar Per mirembajtje te paisjeve mjekesore nga 1.850.000.00-euro qe ka qene ne vitin 2014 ne 850.000.00 ne vitet 2016-2017.²

- **Furnzimi me barëra dhe material hargjues**

² Buxheti sipas viteve nga ligji i cili ishte ligj i dy fazave: i Aprovuar në fillim vitin dhe i rishikuar gjatë vitit.

SHËRBIMI SPITALOR KLINIK DHE UNIVERSITAR I KOSOVËS

Planifikimi real i vitit 2017, për mbulim të listës esenciale i kryer nga Barnatorja Qëndrore e SHSKUK-së do të pasqyrohet në tabelën në vijim:

	Planifikimi Real 2017	Buxheti për 2017	Diferenca	Diferenca në %
QKUK	↑ 19.158.942,52	↓ 9.669.988,00	↓ - 9.488.954,52	- 49,53
SPITALI I PRIZRENIT	↑ 1.782.544,63	↓ 1.440.758,00	↓ - 341.786,63	-19,17
SPITALI I FERIZAJIT	↑ 898.983,93	↓ 528.594,00	↓ - 370.389,93	-41,20
SPITALI I GJAKOVËS	↑ 1.113.549,69	↓ 913.557,00	↓ - 199.992,69	-17,96
SPITALI I MITROVICËS	↑ 1.056.367,24	↓ 430.835,00	↓ - 625.532,24	-59,22
SPITALI I VUSHTTRISË	↑ 178.327,94	↓ 164.568,00	↓ - 13.759,94	-7,72
SPITALI I PEJËS	↑ 1.297.641,54	↓ 1.064.665,00	↓ - 232.976,54	-17,95
SPITALI I GJILANIT	↑ 1.013.044,98	↓ 787.022,00	↓ - 226.022,98	-22,31
Totali	↑ € 26.499.402,47	↓ € 14.999.987,00	↓ - 11.499.415,47	-43,39

Buxheti total i planifikuar për vitin 2017 në SHSKUK, për mbulim të listës esenciale është 26 milion euro, ndërsa buxheti i projektuar për vitin 2017 është 14.9 milion euro, dhe del që kemi një buxhet me një diferencë prej 11 milion euro apo 43.39% më pak. Sipas institucioneve vetëm në QKUK kemi një diferencë prej 9.4 milion euro apo 49.53% më pak.

Përveq kërkesave nga Lista Esenciale kemi kërkesa edhe për produkte jashtë Listës Esenciale nga klinika të ndryshme, klinika të cilat kanë edhe specifika të ndryshme.

Siç shihet në këtë tabelë, kërkesa për produkte jashtë Listës Esenciale nga Klinikat e QKUK, arrinë vlerën prej 1.8 milion euro në total. Klinika e Biokimisë mjekësore kërkon 21% apo 400 mijë euro të produkteve. Mjekësia Nukleare kërkon rreth 370 mijë euro apo 20% të buxhetit.

QKUK	Produktet jashtë Listës Esenciale	%
Kl. e Biokimisë mjekësore	400.000,00	21%
Inst.paraklinike	297.876,00	16%
Ortoprotetika	125.000,00	7%
Mjekësia Nukleare	370.490,00	20%
Kardiokirurgjia	182.283,47	10%
Klinika vaskulare & emergjenca	111.215,50	6%
Kl. e Urologjise	68.835,00	4%
Kl.e Alergologjise	12.400,00	1%
Materiali shpenz. i domosdoshem	300.000,00	16%
Total	1.868.099,97	

Përveq buxhetit shumë të vogël është edhe më shqetsuese lidhja e kontratave të reja për barëra dhe material hargjues nga Ministria e Shëndetësisë. Çmimet e reja të kontraktuara janë shumë më të larta se çmimet aktuale.

SHËRBIMI SPITALOR KLINIK DHE UNIVERSITAR I KOSOVËS

Rreth 3 milion euro do të jetë ndikimi i tyre në buxhet, që nënkupton se nëse nuk kemi shtim të buxhetit në këtë kategori në vitin 2017, nuk mund të kemi furnizim sikur të vitit 2015 apo vitit 2016. Nga ky fakt kemi edhe rritje të planifikimit në vlerë financiare të vitit 2017, për të plotësuar kërkesat nga lista esenciale.


- **Infrastruktura dhe Pajisjet Mjekësore në SHSKUK**

Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitar i Kosovës (SHSKUK), gjatë vitit 2015 dhe 2016 ka përgaditur dokumente mbi nevojat reale për investime kapitale për të gjitha njësitë e saja. Vlera e përafërt e përlogaritur e projekteve kapitale është rreth 60 milion euro.

Investimet Kapitale SHSKUK					
Emertimi	QKUK	Spitalet	Programet tjera shendetesore	Gjithsej	%
Pajisje dhe aparatur mjekesore	39.422.014,00	4.100.000,00	2.063.800,00	45.585.814,00	75%
Renovime dhe ndertime	9.770.200,00	4.623.995,00	727.350,00	15.121.545,00	25%
Gjithsej	49.192.214,00	8.723.995,00	2.791.150,00	60.707.359,00	
%	81%	14%	5%		

Buxheti i projektuar në kategorinë e investimeve kapitale nga Ministria e Financave shihet të jetë mjaftë i vogël krahasuar me kërkesat reale nga njësitë përbërse të SHSKUK-së. Figura dhe tabela në vijim do të pasqyrojnë qartë diferencën ndërmjet projeksioneve shtetore buxhetore karshi kërkesave reale në investime kapitale.

SHËRBIMI SPITALOR KLINIK DHE UNIVERSITAR I KOSOVËS



Projeksioni ne Investimet Kapitale 2017-2019 SHSKUK			
Vitet	Vleruar nga buxheti	Kerkesat nga projektet ideore ne investime kapitale	Diferenca
2017	5.232.378,00		
2018	5.510.000,00		
2019	8.179.823,00		
Totali 2017-2019	18.922.201,00	60.707.359,00	- 41.785.158,00

Në periudhën afat mesme të investimeve kapitale kemi një situatë ku kemi një diferencë prej 41.7 milion euro, vetëm për periudhën 2017-2019. Buxheti i projektuar ndër vite është nga 5 milion deri në 8 milion në vitin 2019. Në total në kornizën afat-mesme të shpenzimeve kapitale (2017-2019) kemi një vlerë të projektuar prej 18.9 milion euro, dhe një kërkesë reale me projekte ideore prej rreth 60 milion euro.

Tabela e rradhës do të tregoj qartë kapacitetin e institucioneve nën varësi të SHSKUK-së, me aparaturë kryesore mjekësore:

SHËRBIMI SPITALOR KLINIK DHE UNIVERSITAR I KOSOVËS

Lloji i pajisjes	Ferizaj	Gjakova	Gjilan	Mitrovica	Peja	Prizren	Vushtri	QKUK	Gjithsej
MRI	0	0	0	0	0	0	0	1	1
CT	0	1	1	1	1	1	1	3	9
Ultrazë	6	8	11	9	8	15	9	24	90
Pajisje endoskopike	1	4	6	4	8	8	8	9	48
Pajisje të hemodializës	16	10	24	17	0	43	0	84	194
Rentgen	0	0	5	3	5	6	4	8	31
Mamografi	0	0	1	0	1	1	2	3	8
Të tjera	65	107	229	189	367	219	144	700	2020
Gjithsej	88	130	277	223	390	293	168	832	2,401

Bazuar në tabelën e mësipërme, shihet se sistemi publik shendetësor i të gjithë Kosovës ka vetëm një Rezonancë Magnetike (MRI) e cila është e vendosur në QKUK. Një investim edhe me 2 MRI në Spitalin e Pejës dhe Spitalin e Prizrenit do të ishin investime mjaftë strategjike, ku dihet që këto komuna e kanë numrin më të madh të banorëve dhe numrin e shërbimeve që ofrojnë, si dhe QKUK-ja do të lirohej shumë.


Në SHSKUK janë 9 CT, 3 në QKUK, dhe në të gjitha Spitalet e Përgjithshme nga një (1). Ndërsa vetëm spitali i Ferizajit nuk posedon as një.

Duhet të ceket se CT në disa njësi përbërse të SHSKUK-së janë jashtë funksionit. CT-ja në Spitalin e Prizrenit nuk është në gjendje funksionale si dhe i ka kaluar vitet e përdorimit, dhe duhet një CT e re. Pothuajse në të gjitha qendrat e Kosovës, CT-të janë mjaftë të amortizuara, prandaj duhet të bëhen investime të reja, në blerjen e tyre.

Në vitin 2016, me amandamentimin e kategorisë buxhetore kapitale, kategori e cila ka kaluar në MSH/AFSH e tani FSSH ka sjellur mjaftë probleme, edhe përkundër kërkesave të mëdha buxhetore për këtë kategori (60 milion euro), janë bërë kërkesa të domosdoshme për pajisje mjeksore për njësitë përbërse të SHSKUK-së në MSH, por gjatë vitit nuk kemi pranuar as edhe një pajisje të vetme të cilat janë shumë të domosdoshme.

- **Mallra dhe Shërbime dhe Shpenzimet komunale në QKUK**

Në shpenzime komunale, bazuar në shumë faktor si vjetërsia e rrjetit të ujit dhe probleme tjera në të, si dhe shtimi i sipërfaqeve të reja si ajo e ambulancave specialiste do të jenë edhe një vend i rritjes së shpenzimeve komunale, duke fillu nga viti 2017 dhe sipas një përlogarie rritja e këtyre shpenzimeve në këtë kategori do të rritet në rreth 200.000.00€.



Nëse bëjmë një krahasim mes buxhetit të propozuar të vitit 2017 sipas limiteve buxhetore dhe kërkesave aktuale të domosdoshme dhe të kontraktuara sipas disa zërave më të rëndësishme buxhetore, por përherë duke pas parasysh kursimet dhe racionalizimet e perhershme dhe të mundëshme vetëm në kategorinë e mallra dhe shërbimeve dhe në kategorinë e shpenzimeve kapitale, do të kemi: Në këto dy kategori Mallra dhe Shërbime dhe Shpenzimet komunale në total sipas limiteve buxhetore kemi një diferencë prej 2.9 milion euro.

Mallra dhe Shërbime kemi buxhet të planifikuar prej 5.2 milion euro, ndërsa vlera të kontraktuara dhe obligime nga agjensitë inspektuese shtetore në të kategorisë mallra dhe

SHËRBIMI SPITALOR KLINIK DHE UNIVERSITAR I KOSOVËS

Shërbime kemi vlerën prej 8 milion euro, dhe një diferencë prej 2.7 milion euro më pak. Tabela në vijim do të pasqyrojë të gjitha zërat e këtyre kategorive:


Kategoria Ekonomike	Pershekrimi	Buxheti i propozuar sipas limiteve buxhetore	Furnizimet e kontraktuara dhe shpenzuar-Aktuale	Diferenca
Mallra dhe Sherbime	Shpenzimet e telef.postare e kabell optik	21.000,00	27.000,00	- 6.000,00 €
Mallra dhe Sherbime	Shpenzimet e sigurimit,këshilluese e të trajnimit	1.171.200,00	1.192.355,00	- 21.155,00 €
Mallra dhe Sherbime	Mobile,kompjuter,fotokopje,paisje special mjeksore<1000.00€	52.200,00	70.000,00	- 17.800,00 €
Mallra dhe Sherbime	Material për zyrë,shtypje blloka e formu	300.000,00	400.000,00	- 100.000,00 €
Mallra dhe Sherbime	Ushqim për pacient e foshnje	897.491,00	1.000.000,00	- 102.509,00 €
Mallra dhe Sherbime	Furnizime mjeksore	770.000,00	1.550.000,00	- 780.000,00 €
Mallra dhe Sherbime	Furnizime pastrimi	185.000,00	200.000,00	- 15.000,00 €
Mallra dhe Sherbime	Furnizim me veshmbathje	60.000,00	90.000,00	- 30.000,00 €
Mallra dhe Sherbime	Mazut	250.000,00	380.000,00	- 130.000,00 €
Mallra dhe Sherbime	Naftë për gjenerator,nxemje dhe vetura	22.500,00	30.000,00	- 7.500,00 €
Mallra dhe Sherbime	Sigurimi dhe regjistrimi I automjeteve	9.750,00	18.000,00	- 8.250,00 €
Mallra dhe Sherbime	Mirmbajtja e automjeteve dhe riparimi	10.000,00	10.000,00	- €
Mallra dhe Sherbime	Mirmbajtja e teknologjis informative	5.000,00	10.000,00	- 5.000,00 €
Mallra dhe Sherbime	Mirmbajtja e paisjeve dhe mobileve	60.000,00	200.000,00	- 140.000,00 €
Mallra dhe Sherbime	Mirmbajtja dhe pastrimi I objekteve	1.390.000,00	1.500.000,00	- 110.000,00 €
Mallra dhe Sherbime	Obligimet nga agjensionet inspektuese		1.357.800,00	- 1.357.800,00 €
Mallra dhe Sherbime	Total	5.204.141,00	8.035.155,00	- 2.831.014,00 €
Shpenzimet Komunale	Rryma	654.999,99	750.000,00	- 95.000,01 €
Shpenzimet Komunale	Uji	440.000,00	440.000,00	- €
Shpenzimet Komunale	Mbeturinat	115.000,00	115.000,00	- €
Shpenzimet Komunale	Ngrohja Qendrore	806.988,01	800.000,00	6.988,01 €
Shpenzimet Komunale	Shpenzimet e telefonit	18.000,00	25.000,00	- 7.000,00 €
Shpenzimet Komunale	Total	2.034.988,00	2.130.000,00	- 95.012,00 €

Siq po shifet nga tabela e lartë shënuar, vërejmë se, në të dy kategorit ekonomike kemi një gjendje jo të mirë dhe mjaft dekurajuese sa i përket buxhetit –shpenzimit e obligimeve aktuale të propozuar sipas limiteve buxhetore për vitin 2017. Bazuar vetëm në shpenzimet dhe obligimet aktuale pa kërkesatë shtëse në mallra dhe shërbime kemi një mungesë buxhetor të pa mbuluar prej minus 2,831,014.00€ për vitin 2017 dhe në shpenzimet komunale një minus prej 95,012.00 €.

SHËRBIMI SPITALOR KLINIK DHE UNIVERSITAR I KOSOVËS

duke i ngarkuar (angazhuar) punëtorët administrativ të QKUK-së si dhe staf tjetër prej njësave tjera përbërse të SHSKUK-së.

Për mos përkrahje në funksionalizim është impovizuar çdo gjë, duke funksionuar sipas organogramës së shfaqur më poshtë:



Gjatë kësaj periduhe drejtorja e përgjithsmë e SHSKUK-së, ka funksionuar me këto pozita:


1. ZKF të SHSKUK-së
2. Zyra e Drejtorit (Këshilltar për çështje ekonomike, këshilltar për analiza dhe monitorim, dhe një asistent)
3. Drejtor për Arsim dhe Shkencë,
4. Koordinaotr të Prokurimit
5. Sektor për mbrojtje të të dhënave
6. Koordinator të infermierisë
7. Koordinator për donacione
8. Bordi i drejtorëve të njësave përbërse të SHSKUK-së
9. Koordinator i barnatorës Qëndrore
10. Zyra për Informim
11. Sektori për siguri dhe shëndet në punë
12. Drejtoria e Shërbimeve të Përbashkëta Tekniko Administrative në QKUK
13. Koordinator për çështje juridike.
14. Koordinator i Qendrave të Shëndetit Mendor

SHËRBIMI SPITALOR KLINIK DHE UNIVERSITAR I KOSOVËS

Pothuajse të gjitha pozitat e lartë cekura janë mbuluar me punëtor të QKUK-së të cilët janë ngarkuar me punë shtesë përveç punëve të përshkruara me kontratë punë.

Përkundër shumë sfidave organizative kemi edhe dobësi në pozitat udhëheqëse-kyçe të cilat nuk po arrijnë të operojnë me sukses.

Për zgjidhje të këtyre problemeve kemi propozuar një strukturë organizative më funksionale e cila është edhe më e thjeshtë dhe më llogaridhënëse, por e njejta është ende në shqyrtim në Bordin Drejtues të SHSKUK-së. Propozim të cilin mund të shikoni në figurën e më poshtme:



Sfidat tjera në Sistemit Shëndetësor-SHSKUK 2014-2017

SHSKUK në fillim të punës është ballafaquar me probleme dhe sfida nga më të ndryshmet, disa nga të cilat po i cekim në raportin në vijim.

- Permbushja e legjilacionit aktual shëndetësor me aktet e nevojshme dytesore që funksionalizojnë Lgjet aktuale që rregullojnë sektorin shëndetësor nëse janë pajtu për këto legjislacion ekzistues (sepse mungesa akaktuale të akteve dytesore legjilative po shkaktojnë pengesa të natyrave të ndryshme sikurse edhe ndërrimi i shpeshtë i legjilacionit po mban sistemin në status quo).
- Shumica e njërive përbërëse të SHSKUK-së, kanë qenë për më shumë se 4 vjet u.d. të drejtorëve, meqë konkuret vazhdimisht kishin dështuar për vite të tëra.
- Njësitë përbërëse janë ballafaquar me mungesë të barnave dhe materialit tjetër shpenzues, madje edhe me ato elementare të domosdoshme për punë.
- Mungesa e buxhetit, apo kufizimi i shpenzimeve buxhetore në mallra dhe shërbime ka paraqitur problem të vazhdueshëm për SHSKUK, ku kontratat e nënshkurara janë më të mëdha se sa ndarja buxhetore në QKUK.
- Në fillim të punës SHSKUK ka trashëguar buxhet të pashpenzuar, sidomos në kategorinë e investimeve kapitale, meqë nuk kishin filluar shumica e projekteve kapitale të parapara për këtë vit buxhetor.
- Mungesë e profesionistëve shëndetësor të lëmijëve specifike si dhe një mungesë shumë e madhe e infermierëve.
- Shumë shërbime dhe pajisje ishin jashtë funksioni, në mungesë të mirëmbajtjes, servisimit prej vitesh dhe mos llogaridhënies, përfshirë CT-të dhe akseleratorët për rrezatim.
- Në shumë klinika, shërbime dhe sektorë nuk kishte raporte pune periodike, përkatësisht plane konkrete të veprimit.
- Nga menaxhmenti i kaluar ishin pranuar një numër i madh i punëtorëve tekniko-administrativ me konkurs publik, madje kishte dhe listë të pritjes dhe shumë nga punëtorëve u ishin bërë kontratat e punës, edhe pse nuk kishte mundësi për tu futur në listë të pagave.
- Çështja e premtimeve nga Qeveria e Republikës së Kosovës për lejimin e të paktën 60 pozitave të reja për punësim, premtim që jo vetëm nuk u realizuan në vitin fiskal 2014, por se kjo rrije nuk është paraparë as në vitin fiskal 2015.

- Shërbimi i kardiokirurgjisë ka qenë sfidë e madhe, ai ishte futur në funksion, por realisht në të kryheshin operacione vetëm kur vinin ekipet nga jashtë, meqë ky shërbim kishte vetëm një kardiokirurg (tani tre), por mungonte edhe stafi tjetër profesionalë, i shuar pas hapjes së shërbimeve tjera.
- Procedurat e prokurimit dhe financave stërzgateshin dhe kjo shpeshherë pengonte zhvillimin normal të punës në njësitë përbërëse të SHSKUK. Procedurat e prokurimit për njësitë përbërëse të SHSKUK përkatësisht për specifikat e sektorit të Shëndetësisë nuk njohin/lejojnë të jenë prioritet ndryshe nga sa parashikon ligji në fuqi.
- Ka qenë vështirësi për QKUK-në, si njësi përbërëse e SHSKUK, e cila nuk kishte lidhje dhe komunikim të rregullt me Spitalet e Përgjithshme dhe si rrjedhojë e kësaj kishte mbingarkim dhe delegim të rasteve për QKUK, madje edhe të rasteve që mund të zgjidheshin në Spitalet e Përgjithshme.
- Në shumë shërbime ishte vërejtur burokraci por edhe “neglizhencë” si dhe mos shfrytëzim të kapaciteteve maksimale të punës.
- Funkcionalizimi i Shërbimit - Instituti i Psikiatrisë Forenzike pa resurset humane dhe të resurseve tjera të planifikuar në dispozicion, madje kjo edhe e pa planifikuar staf shtesë për kompensim të tyre në buxhetin e vitit fiskal. Ishte sfidë jashtëzakonisht e madhe apo u bart në “kurriz” të shërbimeve tjera të QKUK-së.
- Ndërhyrjet e pa drejta politike në sistem, me amandamentimin e neneve të ligjit të buxhetit ku janë tërhequr direkt nga menaxhimi i SHSKUK-së, kategoritë ekonomike Kapitale dhe Barëra me Material Shpenzues, të cilat kanë kaluar në MSH konkretisht AFSH tani FSSH. Ndërhyrje të cilat na kanë sjellur çrregullime në sistem, burokraci të skajshme dhe duplikim të punëve-kanë rënduar për së tepërmi funksionimin administrative dhe funksional.
- Tendencia e Ministrisë së Shëndetësisë për ndalje të reformave shëndetësore, e cila është nënkuptuar për kthim prapa të Insitucioneve Shëndetësore të nivelit dytësor dhe tretësor nën menaxhim të Ministrisë së Shëndetësisë. Ky mos kuptim i reformës shëndetësore ka sjellur një neglizhencë dhe injorim të insitucioneve, të cilat kanë pasur ndikim të madhë në vendim marrje si dhe shtjryje të më tejme të proceseve përpara.
- Mos kompletimi i Bordit Drejtues nga MSH-ja me anëtar të rinjë si dhe shpalljen e konkursit publik për Drejtor Financiar në Bordin Drejtues, ka sjellur situata të rrezikshme, të cilat direkt mund të ndikonin në funksionim të organizatës-pra edhe do të prekin jëtën e qytetarëve të Republikës së Kosovës, për të cilët jemi të obliguar të ofrojmë shërbime shëndetësore. Pasi që Bordi Drejtues i SHSKUK-së është organi më i


lartë vendim marrës në SHSKUK, i cili ka edhe të drejten e nënshkrimit të kontratave publike me operator ekonomik. Dhe më shumë se një vitë e gjysme BD i SHSKUK-së, ka operuar me minimumin e anëtarëve të sajë.

- Mungëse e madhe e buxhetit për edukim të vazhdueshëm profesional i cili është i domosdoshëm për punëtorët shëndetësor. Kjo kategori është lënë jashtë vëmëndjes dhe përkujdesjes- për SHSKUK-në në tërësi e për QKUK-në në veçanti.

Të arriturat në SHSKUK 2014-2017

- Shërbimet Shëndetësore


Figurat në vijim do të paraqes shërbimet kryesore të ofruara nga njësitë përbërëse të SHSKUK-së për periudhën 2014-TM1 dhe TM 2/2017:



Në këtë periudhë prej 2014 deri më gjashtëmuajorin e parë të vitit 2017, janë kryer një numër i konsiderueshëm i shërbimeve nga njësitë përbërëse të SHSKUK për pacient, Ditë Shërbimi ishin 3 milion dhe me mbi 141 mijë operime.


Gjatë kësaj periudhje pacient të shtrirë ishin gjithsej 603 mijë në njësitë përbërëse të SHSKUK-së

Parametra laboratorik në këtë periudhë punë nën menaxhim të SHSKUK-së, janë kryer 9.2 milion shërbime laboratorike dhe 4.5 milion shërbime ambulantore dhe 6 milion shërbime diagnostike dhe të tjera.



Numri i lindjeve në total gjatë kësaj periudhe arrin numrin e 81 667 lindjeve nga të gjitha njësitë përbërse të SHSKUK-së. Numri total nga viti në vitë ka pësuar ndryshime, gjithashtu edhe me

ofrim të shërbimeve të dializës nga viti 2015 deri në periudhën e TM1 dhe TM2-2017 arrinë numrin e 287 859 shërbime të dializës nga të gjitha njësitë përbërse të SHSKUK-së.



Shërbimet radiologjike në SHSKUK dhe Kardiologjike në QKUK					
Vitet	Ct	MRI	Stenta	Koronografi	Pejsmejker
2014	11794	5903	297	1000	76
2015	19033	6312	462	1176	85
2016	32194	6204	249	727	75
2017/6	15771	2261	450	610	21
Gjithsej	78792	20680	1458	3513	257

Në nivel të SHSKUK-së, nga viti 2014 shërbime radiologjike janë ofruar një numër I konsiderueshëm i shërbimeve, por për tu raportuar janë përzgjedhur shërbimet e CT dhe MRI, dhe gjatë kësaj periudhe janë kryer 78 mijë shërbime të CT dhe 20 mijë shërbime të MRI-së. Dhe duhet theksuar se, në nivel vendi kemi vetëm një aparaturë të MRI-së, dhe 9 CT në insitucionet shëndetësore publike të cilat janë nën varësi të SHSKUK-së, gjithashtu duhet përmendet mosha e vjetruar e apraturës e cila ka kaluar numrin e vjetëve të cilat i ka në dispozicion për përdorim.


Nga shërbimet Kardiologjike në QKUK janë vecuar ato më të rëndësishmet Stenta, Koronografi dhe pejsmejker. Nga këto vitë të ofirmit të këtyre shërbimeve janë ofruar 1458 Stenta, 3513 Koronografi dhe 257 Pejsmejker.

- **Buxheti i realizuar në SHSKUK³**

Buxheti në SHSKUK				
Viti	2014	2015	2016	
Total Buxheti	85.917.619,92	87.501.839,99	85.086.651,00	
Buxheti i Shpenzuar	83.573.539,76	86.591.759,49	84.223.477,00	
Mbetja	2.344.080,16	821.367,00	863.174,00	

Gjatë vitit 2014, buxhetin e SHSKUK-së, e ka udhëhequr Ministria e Shëndetësisë, ku total buxheti ishte 85 milion euro, ndërsa buxheti i shpenzuar ishte 83 milion euro me një mbetje prej 2.3 milion euro. Nga viti 2015, nën menaxhim direkt të financave nga SHSKUK me të gjitha kategoritë buxhetore nga 87 milion euro, 86 milion euro ishte arritur të jetë shpepenzimi I tyre. Në vitin 2016, nga total buxheti prej 85 milion euro, është arritur të shpenzohet buxheti prej 84 milion euro dhe me një mbetje prej 863 mijë euro.

³ Buxheti total përfshinë edhe të hyrat vetanake në SHSKUK të cilat janë shtesë në buxhetin e rishikuar si dhe në vitin 2016 në total është shtuar edhe vlera e barërave dhe materialit hargjues si dhe shpenzimet kapitale, huazuar nga Raprotet Financiare të ZKF SHSKUK




Në përqindje realizimi i buxhetti ishte nga 97% në vitin 2014, 99% në vitin 2015 dhe 99% e buxhetit është arritur të shpenzohej nga total buxheti.


- **Furnizimi me barëra dhe material hargjues**

Menaxhimi shumë më i mirë me buxhet për barëra dhe material hargjues, edhe pas zvogëlimit të buxhetit është mundësuar rritje e përqindjes së furnizimit- Me reformën e re në sistemin shëndetësor si dhe me ri organizimin e sektorit farmaceutik, SHSKUK vetëm në vitin 2015 e ka pasur direkt nën menaxhim. Me amandamentime të neneve, ky buxhet ka kaluar nën menaxhim të MSH konkretisht në AFSH-së.

Buxheti i ndarë ndër vite në kategorinë barëra dhe material hargjues, nga viti 2014 ka pësuar rënie nga 15.4 milion në 15.3 milion. Zvoglimi i buxhetit ka vazhduar edhe për vitin 2016, buxheti total në këtë vit ka qenë 14.9 milion euro. Buxhet i njejtë është projektuar edhe për vitin 2017 sikur në vitin 2016.



Furnizimi në SHSKUK, do të pasqyrohet në figurat e më poshtme:




Në QKUK gjatë vitit 2014, furnizimi me citostatik ishte 40.95%, barëra 43% dhe material medicinal 37.2%. Në vitin 2015 furnizimi me citostatik ishte 82%, barëra 76.9% dhe material medicinal 68%. Në vitin 2016 furnizimi me citostatik ishte 70%, barëra 70% të listës esenciale dhe material medicinal 60%

Ndërsa furnizimi nga lista esenciale për Spitalet e Përgjithshme të Kosovës do të pasqyrohet në figurën e më poshtme:

Furnizimi nga lista esenciale për spitalet e përgjithshme gjatë vitit 2015, ishte 84.42% me barëra, ndërsa furnizimi me material medicinal ishte 81.02%.

Në vitin 2016, furnizimi me Barëra ishte 77% ndërsa furnizimi me Material medicinal ishte 74%.



Në figurat e më sipërme shihet kjo furnizimi me barëra me material hargjues nën menaxhimin e SHSKUK-së gjatë vitit 2015, është më i lartë, edhe përkundër zvogëlimit të buxhetit në vitin 2015 si dhe menaxhimi i kësaj kategorie nga MSH/AFSH gjatë vitit 2016. Furnizimi me barna


dhe material shpenzues: Lejimi i shkëmbimeve për përdorimit të barnave dhe materialeve shpenzues brenda njësisë organizative të SHSKUK ka ndikuar që të shfrytëzohen në mënyrë racionale dhe të mos skadojnë shumë produktet që disa njësi kanë pasur më tepër se sa nevojat.

➤ **Sukseset tjera në SHSKUK**

- Pas më shumë se 4 vjetëve u zgjodhën përmes konkursit publik, drejtorët e klinikave, shërbimeve, instituteve në QKUK dhe drejtorët e Spitaleve të Përgjithshme dhe Qendrave Profesionale të Shëndetit Mendor. Me të cilët janë standardizuar raportimet periodike dhe vjetore të punës, planet e punës si dhe komunikimi ka ndryshuar shumë për të mirë. Si dhe është bërë vlersimi i performancës për të gjithë drejtorët.
- Përmes senzibilizimit dhe tërheqjes së vërejtjeve tona mbi gjendjen e aparaturës në nivel të SHSKUK-së, kemi arritur të bëjmë projekte ideore direkt nga menaxherë të tjerë të SHSKUK të cilat i kemi përmbledhur në një koncept document me 60 milion euro, ku nga këto projekte në parim janë aprovuar 50 milion euro investime për aparaturë mjeksore. Si prioritet në tërësi nga MSH dhe Qeverinë e Republikës së Kosovës, përmes kësaj nga Banka Botërore për Ballkan është siguruar donacion prej 250 mijë euro të bëhet studim fizibilitetit e gjendjes në SHSKUK.
- Përmes SHSKUK-së, shteti ynë ka arritur të antarësohet me drejta të plota në UNESCO në BIOETIKË, ku edhe kemi hapur zyrën e Bioetikës në QKUK.
- Me mjaft sukses janë shfrytëzuar burimet njerzore në nivel të SHSKUK-së, ku në pamundësi të shtimit të numrit të punëtorëve, kemi arritur të angazhojmë stafin aktual për mbulesë të hapsirave menaxheriale. Si dhe kemi mbuluar shërbimet e Spitalit të Përgjithshëm Mitrovicë dhe Vushtrrisë.
- I kemi rezistuar nderhyrjeve politike nga jashtë me punë dhe përkushtim profesional.
- Është rritur niveli i raportimeve dhe llogaridhënies nga SHSKUK.
- Janë krijuar grupe punuese për hartimin e rregulloreve të punës në nivel të SHSKUK-së, grupe të cilat kanë kryer punë të shkëlqyer, ku kemi akte të mbredshme të miratuara si dhe nga këto grupe punuese janë krijuar statutet e Spitaleve të Përgjithshme si dhe të Qendres Kombëtare të Mjeksisë së Punës.
- Kemi racionalizuar shpenzimet e kujdestarive të mjekëve në specialicim, kemi aprovuar kujdestari dhe angazhim vec e vec për secilën klinikë sipas nevojës dhe kapaciteteve të tyre.
- Janë siguruar donacione të shumta në nivel të SHSKUK-së, si në ndërtime (P.Sh.Spitali i Vushtrrisë me vlerë rreth 6 milion euro), aparaturë, shtretër dhe barëra dhe material

hargjues (gjatë vitit 2016 për barëra dhe material hargjues kemi pranuar 10 milion euro donacione⁴).

- Janë dizajnuar dhe propozuar organgramet e klinikave dhe shërbimeve të QKUK-së, ku kemi propozime për zvogëlim të pozitave udheheqëse të pa nevojshme.
- Janë themeluar dy sektor mjaft të rëndësishëm në nivel të SHSKUK-së: Sektori për Siguri dhe Shëndet në Punë, sektor i cili për herë të parë ka inicuar dhe menaxhuar vizitat sistematike për punëtorët e SHSKUK-së. Dhe hartimin e rregullores për pagesë të punëtorëve shëndetësor sipas rrezikshmërisë. Gjithashtu është krijuar edhe sektori për Mbrojtje të të Dhënave. Të gjitha këto janë kryer pa staf shtesë dhe me staf aktual i cili nuk është përkrahur me staf nga Qeveria e Republikës së Kosovës edhe pse ishte obligative për ne themelimi i këtyre sektorëve nga Agjensione të Pavarura Shtetore
- Me nënshkrimin e kontratave publike në (QKUK) vitin 2014 për periudhë 24 muajshe për ushqim (Mish Demi, Furnizim me artikuj ushqimor) dhe për servisim të pajisjeve mjekësore është mundësuar një kursim i buxhetit me rreth 1.4 milion euro duke i shfrytëzuar sasitë e nejtja të furnizimit.



⁴ Cmimet janë të tregut të origjinës të prezantuara nga donatorët

SWOT ANALIZA⁵

<p>Forca (Strength):</p> <ul style="list-style-type: none"> • Punëtorët e Kualifikuar • Institucion shtetror • Menaxhues i sistemit dytësor dhe tretësor të Shërbimeve Shëndetësore dhe programeve tjera shëndetësore. • Numri i madh i shërbimeve dhe shërbimet e ndryshme specifike • Fleksibiliteti (Mundësia e transfere të mbrendshme-transferi i burimeve njerzore, barërave dhe mat hargjues, pajisjeve, eksperiencave të mbrendshme, etj) • Numri i madh i sallave operatore • Strukurimi i shërbimeve shëndetësore. • Bashkëpunimi me Universtietin e Mjekësisë. • Motivimi • Reputacion dhe emri i mire i shumë mjekëve specialist. • Numri i mjekëve specialist me performancë të mirë. • Reforma Shëbdetësore me orientim të decentralizimit. • Statutet e Institucioneve Shëndetësore 	<p>Dobësitë (Weaknesses):</p> <ul style="list-style-type: none"> • Buxheti i pa mjaftueshëm; • Paisjet e vjetruara dhe të pa mjaftueshme; • Mosha e madhe e punëtorëve. • Trajnimet dhe edukimi I vazhdueshëm. • Sistemi informativ Shëndetësor SISH • Procedurat burokratike • Prokurimi • Efektiviteti në punë • Llogaridhënia e vogël • Kushtet higjeniko-sanitare • Hapsirë e pa mjaftueshme në shumë institucione shëndetësore • Furnizimi jo adekuat me barëra dhe mat shpenzues. • Mungesë e infermierëve dhe stafit me specializime specifike. • Referimet e pa nevojshme në QKUK • Pagat fikse • Mos menaxhimi i të gjitha kategorive buxhetore-Ngatërrim i përgjegjësive dhe llogaridhënies. • Protokolet shëndetësore • Motivimi. • Siguria dhe shëndeti në punë • Mos mundësia e menaxhimit të të gjitha kategorive ekonomike buxhetore (barëra dhe material shpenzues si dhe Kapitale).
<p>Mundësitë (Opportunities):</p> <ul style="list-style-type: none"> • Sigurimet Shëndetësore • Donacione nga jashtë; • Trajnime; • Partneritetet me institucione tjera jashtë vendit. • Rritja e Emrit të mirë • Institucion Shtetror dhe lidhje direkte me Qeverinë e RKS 	<p>Kërcënimet (Threats):</p> <ul style="list-style-type: none"> • Buxheti shumë i limituar • Pagat Fikse të punëtorëve • Fondi i Sigurimeve Shëndetësore jo funksional. • Zbatimi i ligjit për sigurimet shëndetësore pa investimet adekuate për të ruajtur shërbimet shëndetësore specifike.

⁵ SWOT Analiza- Paraqet analizën ekonomike të një institucioni përmes analizës së Forcës (Strength- S), Dobësive (Weakness-W), Mundësive (Opportunities- O) dhe Rreziqeve- Kërcënimeve (Threats- T). S dhe W janë Forca dhe dobësitë e brendshme, ndërsa O dhe T janë mundësitë dhe rreziqet nga jashtë.

<ul style="list-style-type: none">• Rritja e llogaridhënies• Konkurenca jo e mjaftueshme.• Mundësi e rritjes shumë të të hyrave financiare nga Shërbimet Shëndetësore.	<ul style="list-style-type: none">• Përkrahja institucionale në projekte konkrete shumë jetike dhe domethënëse.• Pajsisjet mjeksore diagnostike• Trajtimi i pacientëve jashtë institucionit.• Korrupsioni (forma të ndryshme)• Furnizimi me barëra dhe material shpenzues (Niveli i ulët i furnizimit dhe çmimet e reja të kontraktuara shumë më të larta).• Lista esenciale për furnizim me barëra dhe material hargjues jo adekuate.• Çmimet e shërbimeve jo te percaktuara drejte• Konkurenca jo e drejtë• Ligjet në fuqi (mundësia e punës dytësore në institucione shëndetësore private, etj).• Centralizimi i Kontratave (psh: për ushqim të cilat kanë çmime më të larta për rreth 15- 20%, dhe ka rrezik në mos realizimin e planifikimeve dhe Liferimin e mallit).• Ikja e Stafit mjekësor jashtë institucioneve Shëndetësore Shtetërore-jashte vendit).• Protokolet-Mungesa e tyre• Detyrimet ndaj agjensive inspektuese• “Lufta” mediale• Përzjerja e kompencave, ndërhyrje në sistem dhe llogaridhënie.• Donatorët e pa qendrueshem• Ndërhyrjet nga jashte.• Ligji i Prokurimit Publik aspak I favorshem dhe jo fleksibil per karakteristikat shendetesore
-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------

Rekomandimet:

Këto rekomandime nuk janë obligative, por qëllim kryesor e kanë përmirsimin e gjendjes aktuale:

- Zbatim i tërësishëm i reformës shëndetësore si dhe ndarja e kuartit të kompetencave sipas ligjit për shëndetësi dhe ligjit për menaxhimin e financave publike.
- Funksionalizimi i Fondit të Sigurimeve Shëndetësore.
- Rritje e bashkëpunimit ndërmjet MSh dhe SHSKUK-së, në hartimin e politikave nacionale.
- Rregullimi i refermieve shëndetësore.
- Përkrahje e plotë e dokumentit për investime kapitale në nivel të SHSKUK-së, kërkesa të cilat paraqesin investime të nevojshme të parapara nga të gjithë drejtorët e njësive përbërse të SHSKUK-së. Këto projekte ideore do të përmirsonin shumë kushtet e punës dhe rritjen e numrit të shërbimeve apo uljen e trajtimeve jashtë vendit/Insitucioneve publike.
- Të mos bëhet rekrutim i stafit shëndetësor pa kërkesë adekuate nga Institucionet shëndetësore kompetente, dhe të bëhet punësimi konform kërkesave reale të shërbimeve shëndetësore.
- Investime adekuate në aparaturë diagnostike në të gjithë Sistemin Publik Shëndetësorë.
- Përkrahja e profesionistë shëndetësor në edukim të vazhdueshëm professional dhe administratës shëndetësore.
- Amandamenti i ligjit të buxhetit për kategoritë ekonomike Kapitale dhe Barëra dhe Material Shpenzues ti kthehen organizatës buxhetore SHSKUK, pasi këto ngatërresa hirearkike kanë vështirësuar punën menaxheriale shumë dhe përgjegjësia apo llogaridhënia është duplikuar dhe si më e rëndësishme, furnizimi gjatë vitit 2016 në këto kategori, si në furnizim me barëra dhe me aparaturë mjeksore është më i vogël, krahasuar me vitin 2015 kur këto kategori janë menaxhuar nga SHSKUK.
- Ndarja e Specializimeve të bëhet konform nevojave dhe kërkesat e njësive përbërse të SHSKUK-së, apo kërkesave të tregut. Pasi kemi edhe raste në një klinikë të QKUK-së, kemi 10 mjek specialist dhe një 1 infermiere. Nga këto imponime vështirohet punë dhe punëtorët nuk mund të jenë efektiv dhe efikas në punë.
- Nëse fillohet mbledhja e premieeve nga fillimi i vitit 2017, më e arsyshme duket të jetë, investimi në projekte kapitale (aparaturë mjeksore diagnostike/operative dhe përmirsim të kushteve të punës). Pasi që vendimi për furnizim 100% të listës esenciale nuk e garanton fuqizimin e SHSKUK-së. Rreziku është se në kuptimin ekonomik,

bararat janë shpenzuese dhe afatshkurtër, kjo kategori ekonomike është pa kthim në investim, apo duhet të shikohet ndonjë kredi e “butë” investive afatgjate apo të përdoret metoda e Leasing-ut për të përkrahur këtë kategori buxhetore të investimeve kapitale.

- Funksionalizmi i Sistemit të Informimit Shëndetësor (SISH) si dhe rekrutim i zyrtarëve të TIK.
- Trajnime urgjente për stafin shëndetësor për përdorim të sistemit informativ shëndetësor. Pasi ky staf do të mbush të dhënat në sistemin e informimit shëndetësor.

Përmirësimi i kushteve të punës si dhe projekti për menaxhimin e performancës së mjekëve specialist si dhe të punëtorëve tjerë shëndetësor, do të mundësojë në rritjen e: përkushtimit ndaj pacientit, sigurinë në punë profesionale, llogaridhënies dhe motivit për punë si dhe do të ndalohej ikja e “trurit” jashtë institucioneve shëndetësore publike të SHSKUK-së.

Konkluzioni:

Qasja e Qeverisë së Republikës së Kosovës ndaj Institucioneve Shëndetësore duhet të jetë më bashkëpunuese dhe më e thellë, pasi që punonjësit shëndetësor kryejn mision të shenjt, duke shpetuar dhe shëruar jetë çdo ditë, dhe nëse arrijmë të rregullojmë sistemin shëndetësor në këtë kohë krize, do të jemi heronjë të kohës.

Financimi me këtë trend në sistemin shëndetësor nuk garanton siguri dhe të ardhme të mirë për institucionet publike shëndetësore të cilat janë nën varësi të SHSKUK-së. Kushtet e dobëta të punës si dhe rritja e konkurrencës do të pa mundësojnë zhvillimin institucional dhe ofrimin e shërbimeve cilësore shëndetësore. Me një trend të tillë të investimeve është vështirë të mbahet një hap zhvillimor dhe konkurues në vend dhe rajon, e kjo do të përcillet me shumfishin e shpenzimeve për transfere jashtë vendit.

Përkrahja e dokumentin për ndihmesë financiare në investime Kapitale do të përmironte punët shumë. Këto investime prej 60 milion sipas dokumentit mund të ndahen në tre vite, duke filluar nga investimet më urgjente dhe strategjike.

Projekti mbi menaxhimin dhe kontrollin e performancës si dhe pagesa sipas performancës do të rregulloj pa barazitë në sistemin shëndetësor, rritjen e motivit dhe llogaridhënien në punë dhe cilsinë e ofrimit të shërbimit.

Funksionalizimi i Sistemit të informimit Shëndetësor SISH, është pjese vitale e reformës shëndetësore, system që do të rregulloj dhe saktësoj inormatat mbi numrin e shërbimeve.

Sistemi Shëndetësor i Kosovës i menaxhuar nga SHSKUK-ja, përveq misionit të shenjtë të cilin e ka për të shpëtuar jetën e pacientit, në të njëjtën kohë mund të jetë një mbështetje e madhe edhe për ekonominë e Republikës së Kosovës. Nëse investohet në aparaturë adekuate dhe mjete të punës, pagë sipas performancës, në sistem të informimit shëndetësor dhe plotësohen rekomandimet dhe duke i eliminuar shumë nga rreziqet e shënuara lartë, SHSKUK mund të gjeneroj të hyra të mëdha financiare sipas projeksioneve të paraqitura në kapitullin e të hyrave financiare në SHSKUK.

Informatat kontaktuese

CURR GJOCAJ
DREJTOR I PËRGJITHSHËM I
SHSKUK-SË



Tel +37744135824
Fax [Fax]
currgjocaj@yahoo.com

LIRIDON GASHI
KËSHILLTAR I ZYRËS SË
DREJTORIT NË SHSKUK



Tel +37745221228
Fax [Fax]
Liridon.gashii@gmail.com